

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

LIGJET DHE TATIMET NË KOSOVË

Zgjidhjet

P4



FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 06.07.2019

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA
A. Zgjidhje shumëfishe	20	
B. Zgjidhje opcionale	20	
1. Problemi 1	15	
2. Problemi 2	8	
3. Problemi 3	7	
4. Problemi 4	10	
5. Problemi 5	15	
6. Problemi 6	5	
Total	100	

1. Kompania "ART", në Tetor lëshon një notë debitore për kompaninë "TRA" për shitjet të cilat i ka bërë para dy muajve. Nota debitore e lëshuar nga "ART" është në vlerë 2,900.40+Tvsh 18%. Për kompaninë "ART" kjo notë ka ndikim në deklaratë të Tvsh-së që:
 - a) rrit Tvsh e zbritshme;
 - b) rrit Tvsh e llogaritur;**
 - c) zvogëlon Tvsh e zbritshme;
 - d) zvogëlon Tvsh e llogaritur.

2. Kompania "ABC" importon mall nga Zvicra. Vlera e faturuar për produkte nga kompania e Zvicrës është 5,000 euro. Kosto e transportit deri në Kosovë është 500 euro. Autoritet doganore kanë bërë rivlerësim të mallit për të cilën kanë vendosur bazën doganore në vlerë prej 6,000 euro (pra rivlerësim prej 1,000 euro) dhe rivlerësim të transportit në 1,000 euro. Sipas kalkulimeve në Dokumentin Unik Doganor (DUD) baza e re i nënshtrohet normës 10% taksë doganore dhe 18% Tvsh. Kompania "ABC" e ka pranuar bazën e paraqitur nga Dogana. Sa duhet të jetë kosto e blerjes që do të vendoset si stoqe/mall në librat e kompanisë "ABC"?
 - a) 6,050.00 euro;
 - b) 6,200.00 euro;**
 - c) 7,150.00 euro;
 - d) 7,700.00 euro;

3. Kompania JONI gjatë muajit Maj 2019 ka pasur dy zyra të marra me qera me kontratë mujore: Zyrja A1: Qeraja bruto 1,100.00 euro dhe Zyrja B1 Qeraja Neto 750,00 euro. Vlerat përkatëse të qerasë janë paguar gjatë muajit Maj 2019. Sa është tatimi i mbajtur në burim (pjesa e qerasë) për muajin Maj 2019?
 - a) 157.59 euro;
 - b) 166.50 euro;
 - c) 173.18 euro;**
 - d) 176.29 euro;

4. Biznesi "CC", person i tatueshëm, me seli në Kosovë ofron shërbime marketingu (të reklamimit të produkteve) në Zvicër, në vlerë të tatueshme prej 10,500.00 euro për kompaninë "SWISS GmbH" që e ka selinë në Zvicër. Për këtë shërbim, kompania kosovare duhet të lëshojë faturën në total:
- a) 10,500.00 euro;
 - b) 11,340.00 euro;
 - c) 12,390.00 euro
 - d) 10,500.00 euro me ngarkesë të kundërt;
 - e) Asnjëra më lartë.
5. Kompania "NEWBORN" shpk, kryen furnizime të tatueshme për të gjitha produktet që shet. Një klienti afarist i ka lëshuar faturën me produkte të përziera, me normë standarde dhe normë të reduktuar. Vlera e Tvsh-së në këtë faturë ka qenë 150.00 euro. 70% e kësaj vlere ka qenë me normë standarde dhe pjesa tjetër me normë të reduktuar. Sa është kostoja e mallit të blerë nga ana e klient?
- a) 130.65 euro;
 - b) 833.33 euro;
 - c) 1,145.83 euro;
 - d) 1,875.00 euro;
6. Kompania "LAB" është biznes i cili tatóhet sipas skemës reale dhe përbëhet nga 3 ortakë (Luli, Aroni dhe Blendi) pra biznes ortakëri. Sipas legjislacionit tatimor ortakëria dhe ortakët me 31.12.2018 duhet të deklarojnë pranë ATK-se:
- a) Ortakëria deklaratën DO ndërsa ortakët se bashku një deklaratë të PD-së;
 - b) Ortakëria deklaron PD ndërsa ortakët secili DO;
 - c) Ortakëria deklaron DO ndërsa secili ortak deklaratën e CD-së;
 - d) Ortakëria deklaron CD ndërsa ortakët secili deklaratën DO;
 - e) Asnjëra më lartë.
7. Kompania "LAB" jep mallra për disa nga klientët e vet me marrëveshje shitje me mundësi kthimi. Si duhet të trajtohen mallrat e dhënë me këtë opcion?
- a) Rregjistrohen si mallra në stoque tek LAB;
 - b) Regjistrohen si mallra në stoque tek klienti;
 - c) Nuk regjistrohen nga ana e klientit;
 - d) Asnjëra më lartë;

8. Për qëllime tatimore për njohjen e KMSH në fund të vitit cila metodë lejohet për trajtimin e stoqeve?
- a) Lejohet metoda FIFO dhe LIFO;
 - b) Lejohet metoda LIFO dhe Kosto Mesatare;
 - c) Lejohet metoda Kosto Mesatare dhe HIFO;
 - d) Asnjëra më lartë.
9. Shuma e lejuar si zbritje për zhvlerësim në periudhën tatimore përcaktohet duke aplikuar përqindjet e mëposhtme në mënyrë individuale të pronës së prekshme individuale sipas metodës lineare në fund të periudhës tatimore dhe atë sipas kategorisë si cilës i përket asetet përkatëse. Cila nga të mëposhtmet është e saktë?
- a) Kategoria 1: pesë për qind (5%);
 - b) Kategoria 2: dhjetë për qind (10%)
 - c) Kategoria 3: pesëmbëdhjetë për qind (15%)dhe
 - d) Kategoria 4: njëzet për qind (20%);
10. Biznesi FLANDRA shpk ka lëshuar një objekt me qera në vlerë 1,500 euro Bruto një biznesi për qëllime afariste, veprimtaria afariste e të cilit është shërbime të dizajnit dhe arkitekturës, e cila për qëllime tatimore është biznes i regjistruar si Korporatë e Vogël me Tvsh. Sa është norma e tatimit në qera të cilën duhet ta ndalë dhe paguajë klienti i FLANDRA shpk?
- a) 0%;
 - b) 3%;
 - c) 9%;
 - d) 10%;

1. Mospagesa e detyrimit tatimit ne kohen e parapare me ligjet tatimore, bazuar ne Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat do te paguaje një gjobë prej 0.5% në muaj apo pjesë të muajit, por jo me shumë se 6% (12 muaj).

E saktë

E pasaktë

2. Blerjet për të cilat një faturë është lëshuar duhet të futet në librin e blerjeve brenda 15 ditëve pas pranimit të faturës së blerjes. Poashtu, Shitjet për të cilat një faturë e shitjes është lëshuar duhet të futet në librin e shitjeve brenda 15 ditëve pas lëshimit të faturës së shitjes.

E saktë

E pasaktë

3. Puna provuese sipas Ligji të Punës mund të zgjatë më së shumti gjashtë (6) muaj.

E saktë

E pasaktë

4. Sipas dispozitave te ligjit nr. 03/L-162 Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave Shpenzimet për përmirësimin e pronave me qira të cilat përdoren për veprimtari ekonomike të tatimpaguesit do të kompensohen përmes zbritjeve të zhvlerësimit të llogaritura për periudhën/vitin e parë të qirasë.

E saktë

E pasaktë

5. Sipas Ligjit te Tvsh një biznes me rastin e përlllogaritjes së pragut për regjistrim në Tvsh (përveç regjistrimit vullnetar), personi duhet të marrë parasysh shumën totale të të gjitha furnizimeve të tija përgjatë periudhës së 12 muajve të fundit dhe kjo shume të jetë mbi 30,000 euro.

E saktë

E pasaktë

6. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në rastet kur tatimpaguesit paraqesin në ATK, kërkesë për pagesë të tatimit me marrëveshje me këste, interesi do të rrjedh nga muaji që pason muajin në të cilin marrëveshja është vendosur/lidhur deri sa është paguar obligimi në tërësi.

E saktë

E pasaktë

7. Sipas Ligjit të TVSH-së, Notë krediti kuptojmë – dokument i lëshuar për qëllim të një rregullimi nga personi i tatueshëm për pranuesin e mallrave ose shërbimeve, pasi që të jetë lëshuar fatura tatimore ose një dokument që shërben si faturë, ku shumat e TVSH-së së ngarkuar në faturën tatimore ose në dokumentin që shërben si faturë, është me i vogël se obligimi real i TVSH-së për atë furnizim të tatueshëm.

E saktë

E pasaktë

8. Bazuar në Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, një tatimpagues mundet të dorëzojë një ndryshim deklarate tatimore nëse ai ose ajo më vonë zbulon gabim në deklaratën tatimore të cilën e ka dorëzuar tashmë. Afati për të dorëzuar një ndryshim deklarate është jo më vonë se gjashtë (6) vjet pas datës obligative kur deklarata është dorëzuar fillimisht.

E saktë

E pasaktë

9. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo transaksion deri në 500 euro, i bërë në mes të personave të përfshirë në aktivitete ekonomike kërkohet të bëhet kesh (me para në dorë).

E saktë

E pasaktë

10. Sipas ligjit nr. 05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale, shpenzimet për qiratë e banesave, të cilat shërbejnë për akomodimin dhe fjetjen e punonjësve rezident dhe jo rezident, pavarësisht nga kushtet e kontratës së punësimit apo shërbimit nuk janë shpenzime të lejueshme.

E saktë

E pasaktë

11. Sipas ligjit nr. 05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale, secili person fizik afarist, ortakëri apo grupim i personave, i cili iu paguan interes apo të drejta pronësore, përveç interesit që është i liruar sipas këtij ligji, personave rezidentë apo jo rezidentë, do të mbajë në burim tatimin nëntë për qind (9%) në kohën e pagesës apo kreditimit.

E saktë

E pasaktë

12. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosove, minimumi i lejuar për pagesën e kontributit pensional nga punëdhënës për të punësuarin është 5% e pagës.

E saktë

E pasaktë

13. Sipas Ligjit "Për Shoqëri Tregtare", shoqëria e regjistruar tregtare ose shoqëria e huaj tregtare, por jo ndërmarrja individuale nuk mund të shfrytëzojnë një emër tjetër tregtar i cili është i ndryshëm nga emri i regjistruar zyrtar.

E saktë

E pasaktë

14. Furnizim i barnave do të jetë i liruar nga ngarkesa me TVSH.

E saktë

E pasaktë

15. Sipas ligjit të TVSh-se, furnizimet me ujë, përveç ujit të ambalazhuar aplikohet norma standarde (18%).

E saktë

E pasaktë

16. Sipas ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo shumë e tatimit e paguar mbi shumën e detyrimit tatimor (mbipagesë), me kërkesën e tatimpaguesit do të kreditohet ndaj detyrimit aktual të tatimpaguesit për detyrimin tatimore të llogarive të ndryshme tatimore.

E saktë

E pasaktë

17. Sipas ligjit nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, shpenzimet e përfaqësimit do të jenë të kufizuara në një përqind (1%) të të ardhurave bruto vjetore.

E saktë

E pasaktë

18. Sipas ligjit nr. 06/L-032 për “Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim”, raporti i auditimit nënshkruhet nga auditori ligjor, ku firmoset edhe data e nënshkrimit; kur një firmë auditimi kryen auditimin, raporti i auditimit nuk nënshkruhet nga auditori ligjor që kryen auditimin në emër të firmës së auditimit;

E saktë

E pasaktë

19. Bazuar në ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo tatimpagues pa marrë parasysh qarkullimin vjetor, përveç mbajtjes së librave dhe regjistrimeve të parapara me ligj, kërkohet të bëjë dhe mbajë regjistrimin e mallrave në stoqe në fund të vitit kalendarik. Regjistrimet e parapara sipas këtij paragrafi duhet të jenë të gatshme më apo para 10 janarit të vitit vijues.

E saktë

E pasaktë

20. Sipas ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, të gjithë personat e angazhuar në tregti ose afarizëm të cilët taten në bazë të të hyrave reale dhe që bëjnë blerje të mallrave ose shërbimeve nga personi tjetër i tatueshëm në gjithsejtë pesë mijë euro (5,000€) e më shumë në çdo vit të tatueshëm, duhet të paraqesin deklaratë të vërtetë dhe të saktë duke raportuar blerjet e tilla tek ATK-ja. Deklaratat vjetore obliguese me këtë nen do të dorëzohen në ATK.

E saktë

E pasaktë

Pjesa C. Pyetjet problemore

Problemi 1

15 pikë

KLERTI COM LLC e regjistruar në Tvsh ka pasur shitje të tatueshme me normë standarde gjatë muajit tetor 2018 në shumë prej 75,000.00 euro. Gjatë kësaj periudhe kjo kompani ka eksportuar mallra në vlerë 15,000.00 euro jashtë vendit, të cilat këto mallra ishin blerë gjatë muajit Shtator me kosto prej 4,000.00 euro (plus Tvsh me normë standarde) por nuk ishin regjistruar në libra të blerjes sepse fatura ishte vonuar.

Gjatë të njëjtës periudhë kompania KLERTI COM LLC ka pasur blerje vendore me normë të reduktuar prej 12,000.00 euro (plus Tvsh) si dhe blerje vendore me normë standarde prej 25,000.00 euro (plus Tvsh). Fatura e shpenzimetve të qerasë për muajin tetor ishte 1,200.00 euro. Qeradhënësi është biznes jo i tatueshëm për Tvsh.

Kompania gjatë muajit tetor importoi një mjet transportues me vlerë (kosto) prej 14,000.00 euro plus transporti prej 1,000.00 euro. Dogana e aplikueshme për këtë pasuri është 10%. Shpenzime të tjera për këtë pasuri nuk ka.

Kompania poashtu gjatë muajit tetor kishte pranuar një notë krediti me normë standarde prej 1,500.00 euro (plus Tvsh) si dhe kishte lëshuar një notë debitore prej 500.00 me normë të reduktuar të Tvsh-së.

Kërkohet:

Përpiloni ekstraktin e deklaratës së Tvsh-së sipas renditjes se sa ka pagesë/kreditim për muajin 10/2018 biznesi në fjalë duke marrë parasysh kreditimin e bartur të muajit Shtator prej 2,160.00 euro (pa përfshirë faturën e paregjistruar në muajin Shtator)?

Zgjidhje: Ekstrakt i deklaratës mujore Tetor 2018:

[TV] FORMULARI I DEKLARIMIT TË TVSH			
Periudha e Deklarimit:	Kolona [1]	10	2018
Numri Fiskal:	Kolona [3]	600600600	
Emri i biznesit:	Kolona [4]	KLERTI COM LLC	
Adresa e biznesit:	Kolona [5]	PRISHTINE, KOSOVE	
Emri i personit kontaktues dhe telefoni:	Kolona [6]	Klerti Berisha 044/123123	
		Furnizimet Vlera	TVSH
Eksportet	Kolona [11]	15,000	
Shitjet e tatueshme me normën 18%	Kolona [12]	75,000	13,500
Nota debitore e lëshuar,nota kreditore e pranuar me normë 18%	Kolona [16]	1,500	270
Nota debitore e lëshuar,nota kreditore e pranuar me normë 8%	Kolona [18]	500	40
		Kolona [30]	13,810
		Blerjet Vlera	TVSH
Blerjet dhe importet pa TVSH	Kolona [31]	1,200	
Importet investive me normë 18%	Kolona [39]	16,500	2,970
Blerjet vendore me normë 18%	Kolona [43]	25,000	4,500
Blerjet vendore me normë 8%	Kolona [45]	12,000	960
		Kolona [67]	8,430
		Kalkulimi Vlera	
Teprica a TVSH-së e bartur nga muaji i kaluar	Kolona [68]	2,880	
Balanca kreditore e mbetur 69 = ((67+68)-30)>0	Kolona [69]	-	
Kërkesa për rimbursim	Kolona [70]	-	
Kreditimi i tvsh-së per muajin pasues 71 =(69-70)	Kolona [71]	-	
TVSH që duhet të paguhet 72 =(30-67-68)>0	Kolona [72]	2,500	

Sqarim: Imp. investive:14,000 (pasuria) + 1,000 (transporti) =15,000+1,500 (10% doganë)= 16,500.

Kreditimi i bartur: 2,160 + 720 (vlera e Tvsh-së për faturën e paregjistruar) = 2,880.

Problemi 2

8 pikë

Gjatë muajit Mars 2018, "DIONI" shpk regjistrojë blerje në shumën prej 20,000 euro (Tvsh me normën 18%); shitje vendore 15,000 euro (me normë 18% të Tvsh-së); shitje të përjashtuara pa të drejtë kreditimi 33,000 euro. Në muajin Mars 2018, poashtu DIONI shpk ka lëshuar një Note Debiti për një blerës për një shitje në muajin Janar 2018, vlera e Tvsh-së në këtë Note Debiti është 1,000 euro (me normë standarde të Tvsh-së).

"DIONI" shpk poashtu në këtë muaj kishte një kreditim të bartur nga muaji paraprak në vlerë prej 3,300 euro. (Vlerat e paraqitura NUK përfshijnë Tvsh-në). Sa për informatë "DIONI" shpk gjatë vitit 2017 regjistrojë blerje në shumën prej 420,000 euro. Shitjet vendore ishin 780,000 euro dhe eksportet ishin 50,000 euro. Shitjet e përjashtuara pa të drejtë kreditimi për vitin 2017 ishin 350,000 euro. (Vlerat e paraqitura NUK përfshijnë Tvsh-në).

Kërkohe:

a) Sa është koeficientit i Tvsh-së së zbritshëm për vitin 2017?

Zgjidhje:

$$\begin{aligned} \text{KT} &= \frac{\text{Furnizimet e tatueshme} + \text{Eksportet}}{\text{Furnizimet e tatueshme} + \text{Eksportet} + \text{Furnizimet e përjashtuara}} \times 100 = \\ &= \frac{780,000 + 50,000}{780,000 + 50,000 + 350,000} \times 100 = \sim 70\% \end{aligned}$$

Problemi 3**7 pikë**

Korporata "ABC" me seli në Prishtinë, gjatë periudhës 01.07.2018 - 30.09.2018 ka pasur qarkullim nga tregtia në vlerë prej 2,250.00 euro, ndërsa të hyrat nga shërbimet për të njëjten periudhë kanë qenë në vlerë prej 750.00 euro. Shpenzimet për këtë periudhë kanë qenë 1,100.00 euro plus pagat bruto (përfshirë kontributin e punëdhënësit) 750.00 euro. Kjo korporatë nuk është tatimpagues që të tatimohet në baza reale.

Kërkohet:**Të llogritet tatimi në të ardhura të korporatave për tremujorin e tretë (TM3)?****Zgjidhje:**

Tatimi për të hyrat nga tregtia	= 2,250.00 x 3% = 67.50
Tatimi për të hyrat nga shërbimet	= 750.00 x 9% = 67.50
Totali tatimi për periudhë:	135.00

Problemi 4**10 pikë**

Kompania LULI LLC e cila kishte filluar aktivitetin disa vite më parë, me datë 31.12.2018 kishte këtë gjendje të aseteve sipas kontabilitetit. Vetura me nr. rendor 4 konsiderohet veturë luksoze dhe shfrytëzohet 50% për qëllime biznesore. Dogana e aplikueshme 10%.

#	Përshkrimi i pasurisë	Furnitori	Kosto e blerjes	Baza doganore e vlerësuar nga Dogana	Vlera me Tvsh	Data e Blerjes
1	Mercedes C220	ARTI shpk	5,000		5,900	31.01.2015
2	Renault Megane	AS VETURA	6,000		7,080	06.03.2013
3	Peugeot 508	SWISS GmbH	6,000		7,080	09.02.2018
4	Audi A8 Black edition	LUXORY AS	38,000		44,840	16.08.2018
5	Kamion MAN 325T- i përdorur	GERMAN AG	6,000	12,000	15,576	27.11.2017
6	Lokali në Prishtinë (70m2)	DIONI shpk	140,000		165,200	29.09.2012
7	Toka në Matiqan (12 ari)	KLERTI BERISHA	66,000		66,000	27.11.2017
8	Rafte për depo (1000kg)	RAFTI shpk	5,500		6,490	19.09.2018
9	Klima ftohese për depo `12	KLIMA shpk	3,000		3,540	19.02.2018
10	Licence për depo 5 vjeçare	MINISTRIA E SHËNDETËSISË	4,000		4,000	27.07.2018
			279,500	-	324,290	

Kërkohet:

Të llogaritet zhvlerësimi/amortizimi sipas Ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave për vitin që përfundon me 31.12.2018?

Zgjidhje:

#	Përshkrimi i pasurisë	Furnitori	Kosto e blerjes	Baza doganore e vlerësuar nga Dogana	Data e Blerjes	Zhvlërimi/Amortizimi për vitin 2018
1	Mercedes C220	ARTI shpk	5,000		31.01.2015	=5,000 x 20% = 1,000 euro
2	Renault Megane	AS VETURA	6,000		06.03.2013	nuk zhvlërohet pasi ka kaluar jetën e përdorimit të lejuar.
3	Peugeot 508	SWISS GmbH	6,000		09.02.2018	=6,000 x 20% = 1,200 euro
4	Audi A8 Black edition	LUKSORY AS	38,000		16.08.2018	= 38,000x50% = 19,000 (për qëllime të ATK-së pranohet vetëm 50% e vlerës);(19,000 x 20%) / 2 = 1,900 euro; (blerja është bërë në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2018)
5	Kamion MAN 325T- i përdorur	GERMAN AG	6,000	12,000	27.11.2017	= 6,000+(12,000*10%) = 7,200 euro ; (për qëllime të ATK-së pranohet fatura e blerje plus dogana e paguar);(7,200 x 20%) = 1,440 euro
6	Lokali në Prishtinë (70m2)	DIONI shpk	140,000		29.09.2012	=140,000 x 5% = 7,000 euro
7	Toka në Matiqan (12 ari)	KLERTI BERISHA	66,000		27.11.2017	nuk zhvlërohet.
8	Rafte për depo (1000kg)	RAFTI shpk	5,500		19.09.2018	=5,500 / 5 vite = 1,100/2 =550 euro (blerja është bërë në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2018)
9	Klima ftohese për depo `12	KLIMA shpk	3,000		19.02.2018	=3,000 x 20% = 600 euro
10	Licence për depo 5 vjeçare	MINISTRIA E SHËNDETËSISË	4,000		27.07.2018	=4,000 / 5 vite = 800/2 =400 euro (amortizim;; (blerja është bërë në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2018)
			279,500	-		

Problemi 5**15 pikë**

Kompania RIANI shpk me seli në Fushë Kosovë, e regjistruar me Tvsh ka paraqitur informatat relevante në vijim sa i përket aktivitetit të saj afarist për vitin e parë të afarizmit: Shp. e zhvleresimit 1,500.00 euro, Shitjet e tatueshme 97,940.00 euro (përfshirë Tvsh 18%), Stoqet në fillim të vitit 10,000.00 euro (me kosto), Eksportet 21,800 euro, Pagat 7,000.00 euro (përfshirë KP të punëdhënësit), Blerjet e mallit 76,700.00 euro (përfshirë Tvsh 18%), Blerjet e mallit 48,600.00 euro (përfshirë Tvsh 8%), Shitjet pa Tvsh 15,000.00 (me të drejtë kreditimi), Shpenzimet tjera me fature (përfshirë Tvsh 18%) 2,360.00 euro, Shpenzimet tjera me fature (pa Tvsh): 1,200.00 euro, Shitjet e tatueshme 34,560.00 euro (përfshirë Tvsh 8%), Shpenzimet me kupona fiskal 1,600 euro (përfshirë Tvsh 18%), Shpenzime familjare të paguara me kartelë të biznesit 500 euro.

Kthimet e mallit të shitur gjatë vitit kanë qenë 1,800.00 euro plus Tvsh 18%.

Stoqet në fund te vitit 15,000.00 euro (me kosto)

Norma e tatimit në fitim është 10%.

Kërkohe:

- a) Të përpilohet pasqyra e të ardhurave sipas ligjit TAK ? **10 pikë**
 b) Sa është marzha Bruto dhe Neto mbi shitjet për periudhën e vitit ? **5 pikë**

Zgjidhje:

Shitjet me 18%	83,000.00	<----- (97,940/1.18)
Shitjet me 8%	32,000.00	<----- (34,560/1.08)
Eksportet	21,800.00	
Shitjet pa Tvsh me të drejtë kreditimi	15,000.00	
Kthime e shitjeve me 18%	<u>-1,800.00</u>	
SHITJET NETO:	150,000.00	
KMSH:		
Stoqet në fillim	10,000.00	
+Blerjet me 18%	65,000.00	<----- (76,700/1.18)
+Blerjet me 8%	45,000.00	<----- (48,600/1.08)
-Stoqet në fund	15,000.00	
	<u>105,000.00</u>	
Fitimi Bruto	45,000.00	
Shpenzimet e pagave	-7,000.00	
Shpenzimet e zhvleresimit	-1,500.00	
Shpenzimet tjera (me Tvsh)	-2,000.00	<----- (2,360/1.18)
Shpenzimet tjera (pa Tvsh):	<u>-1,200.00</u>	
Fitimi para tatimit	33,300.00	
Tatimi @10%	<u>-3,330.00</u>	
Fitimi Neto	29,970.00	

Marzha bruto mbi shitjet: $45,000/150,000 = 30\%$

Marzha neto mbi shitjet: $29,970/150,000 \sim 20\%$

Problemi 6

5 pikë

Klerti Krasniqi në muajin Qershor 2019 ka pasur rrogën Bruto bazë prej 650.00 euro (punë primare). Për muajin Qershor e tutjet, menaxhmenti vendosi që paga e Klertit të rritet për Neto vlerë prej 50.00 euro.

Kërkohe:

- Sa do të jetë paga Bruto në muajin Qershor të vitit 2019 për Klertin?
- Llogaritni detyrimin e tatimit në paga dhe KP për muajin Qershor 2019 për Klertin?

Zgjidhje:

a) Paga baze $650.00 \text{ bruto} + 50/0.855 = 708.48$.

b) Kontributi pensional dhe Tatimi ne pagë:

$$\text{KP} = 708.48 \times 5\% = 35.42 + 35.42 = 70.84$$

$708.48 - 35.42 = 673.06$ (baza për tatim):

0 - 80	=> 0%	= 0.00
80 - 250	=> 4% - $170 \times 4\%$	= 6.80
250 - 450	=> 8% - $200 \times 8\%$	= 16.00
450 - 673.06	=> 10% - $223.06 \times 10\%$	= 22.31
	TAP	= 45.11